

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË MBZHRAU

Raporti Përfundimtar i Auditimit të Ushtruar në Ministrinë e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave me Objekt Auditimi “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë ekonomiko financiare” për periudhën 01.07.2012 deri më 30.09.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 3 datë 10.01.2014.

Bazuar në nenin 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", i ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000 me shkresën nr. 717/9 datë 13.01.2014, dërguar z. Edmond Panariti, Ministër i Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i procedurave të prokurura fokusuar në parimet themelore të prokurimit publik, si transparenca, nxitja e konkurrencës, barazia e kandidatëve për përdorimin efektiv të fondeve publike u konstatuan mangësi të njëjta për procedurat e audituara të lidhura me mungesën e harmonizimit të punës midis njësive së hartimit të dokumentacionit dhe komisionit të vlerësimit të ofertave dhe qëndrime të ndryshme teknike të këtyre strukturave, interpretime dhe keqinterpretime të cilat ndikojnë edhe në nxitjen e ulët të konkurrencës në këto tenderime. Bazuar në këtë fakt në drejtim të përmirësimit të punës që do të shoqërohej me një efikasitet të plotë të fondeve në arritjen e objektivave të këtij institucioni të rëndësishme, **është rekomanduar që:**

- Nga MBZHRAU të merren masa, për të ndryshuar përbërjen e Njësive së Prokurimit Publik dhe të bëjë të mundur trajnimin e vazhdueshëm të anëtarëve të njësive së prokurimit publik nëpërmjet APP-së, për çështjet e prokurimit publik, kjo në përmbushjes të kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 1, germa “b”. Gjithashtu për të ardhmen anëtarë të KVO-ve të caktohen vetëm specialist të fushës sipas tenderëve objekt prokurimi, kjo në respektim të kërkesës së VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu V, pika 2, germa “ç”.

Menjëherë

- Nga Njësia e Prokurimit Publik për të ardhmen të merren të gjitha masat, që kërkesat kualifikuese të hartohen në përputhje me natyrën dhe përmasat e objektit që kërkohet të prokurohet, të vendosen kritere të nevojshme, pa lënë shteg për interpretime edhe shumë të kuptueshme deri tek bizneset e vogla si dhe të detajohen sipas DST. Për kërkesat kualifikuese të miratuara detyrimisht të kërkohen shoqërimet me dokumentet vërtetues si dhe të përcaktohen organet përkatëse që lëshojnë dokumente të tilla vërtetuese. Këto në respektim edhe të nenit nr. 46 të LPP.

Vazhdimisht

2. Auditimi konstatoi se, MBUMK nëpërmjet titullarit ka urdhëruar, që objektet e prokurimit me fonde mbi 1 milion lekë do të përqendrohen në ministri, ndërsa për ato nën vlerën 1 milion lekë do të prokurohen nga çdo njësi vartëse. Duke parë problematikën e pamundësisë së supervizimit të

plotë të këtyre tenderëve nga vetë institucioni (forma e përdorur deri më sot rezulton se janë jashtë kontrollit si drejtuesit e punimeve ashtu edhe kolaudatorët. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Nga MBZHRAU të merren masa, që për tenderët e ndërtimit të përqendruara të njësive vartëse, mbas delegimit për të lidhur kontratat përkatëse me fituesit e tenderëve, tu lihet autoriteteve kontraktore (njësive vartëse) që të caktojnë vetë supervisorët (drejtuesit e punimeve) dhe kolaudatorët, me qëllim që ministria vetëm kur ta shikojë të nevojshme të bëjë kontrolle të veçanta. Këto në përmbushje të përcaktimeve të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, me ndryshimet, Kreu VIII, pika 2, që cilëson se të drejtën e ka autoriteti kontraktor.

Vazhdimisht

3. Nga KVO-të të merren masa, që të gjejë zbatim edhe neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 4 e LPP, në lidhje me fituesin e tenderit, kur ka konkurrentët që paraqiten me vlera anomalisht të vogla, vetëm për rastet që ka devijime të vogla, dhe kur të gjithë konkurrentët paraqiten me ndonjë mos plotësim të kërkesës kualifikuese që nuk cenon realizimin e projekteve dhe janë të gjitha mundësitë të riparohen në vazhdim të procedurës së prokurimit.

Vazhdimisht

4. Nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave(MBZHRAU) të merren masa që oponenca për projektet dhe preventivat e objekteve që zhvillohen nga ky institucion të bëhen, konform dispozitave ligjore në fuqi dhe kostoja e objekteve të mbështetet në çmimet e Manualit të preventivimit Nr. 3 të punimeve të Ndërtimit

Menjëherë

5. Nisur nga fakti se në objektin “Vendosja e dy elektropompave në Hidrovorin Porto Romano - Durrës” nuk janë kryer plotësisht punimet për nën objektin “F+V tubacione special të linjës shkarkuese+rakorderi+aksesorë+valvula” me vlerë sipas ofertës fituese 604,350 lekë. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Të ngrihet një grup pune me përfaqësues të MBZHRAU-Tiranë dhe Bordit të Kullimit Durrës për të konkluduar kryerjen ose mos kryerjen e punimeve të nën objektit “F+V tubacione special të linjës shkarkuese+rakorderi+aksesore+valvula” për objektin “Vendosja e dy elektropompave në Hidrovorin Porto Romano-Durrës”.

Menjëherë

6. Nga auditimi mbi punën projektuese e preventivuese, për objektet e projektuara nga të tretë, rezultoi se nuk është bërë oponenca për anën ekonomike të preventivave. Në tre rastet e evidentuara në raport, është konstatuar rritje artificiale e vlerave të preventivuara në shumën 15,121,904 lekë me T.V.SH, fakt që tregon se Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore e MBZHRAU-Tiranë, e cila me specialistët e saj të fushës së ndërtimeve miraton dhe përcjell për zbatim, pranë Bordeve të Kullimit, projektet e zbatimit dhe preventivat përkatës, nuk e realizon me përgjegjësi maksimale këtë detyrë. Ky problem është trajtuar edhe në auditimin e mëparshëm, por nuk ka gjetur zgjidhje të plotë. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Oponenca teknike-ekonomike, që lidhet me cilësinë e projekteve të zbatimit dhe të kostos (preventivave) të objekteve ndërtimore që duhet të kryet nga ana e DTTB-së, të jetë e cilësuar zyrtarisht si pjese e dokumentacionit të tenderimeve.

Vazhdimisht

7. Nisur nga fakti se grupi i auditimit të K.L.SH-së nuk disponon mjete lundruese dhe aparatura dixitale të nevojshme për të përcaktuar batimetrinë e krahut të djathtë të shtratit të lumit Buna, ku janë kryer dhe do të kryen punime për mbrojtjen nga gërryerjet të tokave bujqësore si dhe për të saktësuar volumet shtesë të punimeve, **është rekomanduar që:**

- MBZHRAU-Tiranë të ngrejë një grup pune me specialist të fushave për të verifikuar dhe saktësuar me mjete të dixhitalizuara kuotën e poshtme të shtratit të lumit, ta krahasojë atë me kuotën e sipërme në kokë dhe në fund të paneleve tërthorë e gjatësorë dhe të paraqes me një projekt të plotë batimetrinë e krahut të djathtë të lumit Buna në çdo pozicion të 14 paneleve të ndërtuara e për më tej deri tek peneli 19 për objektin “Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Buna, Oblikë, Ana e Malit Shkodër”.

Menjëherë

8. Komisioni i vlerësimit të ofertave dhe Qendra e Transferimit të Teknologjive Bujqësore të MBZHRAU nuk ka bërë interpretimin e çmimeve të paraqitura nga shoqëria [REDAKTUAR] për objektin “Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Buna, Oblikë, Ana e Malit Shkodër” faza e dytë e cila për konkurrim të të njëjtit objekt ka paraqitur dy standarde çmimesh për zëra të njëjtë punimesh. **Për këtë është rekomanduar që:**

- MBZHRAU-Tiranë të përcaktojë shkallën e përgjegjësisë lidhur me rregullshmërinë e llogaritjes së fondit limit të objektit “Mbrojtja nga gërryerjet e lumit Buna Fshati Oblikë, Ana e Malit Shkodër” faza e dytë.

Menjëherë

9. Me gjithë eksperiencën e krijuar në vite për mënyrën e projektimit dhe zbatimit të veprave mbrojtëse të tokave bujqësore nga gërryerjet e lumenjve, mbrojtjen e argjinaturave të lumenjve etj. akoma nuk janë unifikuar dhe standardizuar zgjidhjet funksionale e statike si dhe analizat teknike të çmimeve të zërave të punimeve që lidhen me ndërtimin e paneleve tërthorë e gjatësorë me gurë kave të dimensioneve të ndryshme, shtresat e betoneve sipas markave, veshjet me beton ose me gurë të argjinaturave, ndërtimi i gabioneve me gur kave etj. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Të ngrihet një grup pune nga ana e MBZHRAU-Tiranë, për të ndërtuar këto analiza specifike për mbrojtjen nga gërryerjet dhe mbrojtjen e argjinaturave të lumenjve Drini, Buna, Erzeni, Devolli, Shkumbini, Semani, Shushica, Vjosa etj. Në këto analiza të mos përfshihen shpenzimet e transportit të materialeve me auto nga vendi i prodhimit deri në objekt. Këto shpenzime transporti të preventivohen me vete në funksion të largësive kilometrike. Analizat e hartuara të dërgohen për miratim pranë Ministrisë Transporteve dhe të jenë pjesë përbërëse e Manualit të Preventivimit Nr. 3.

6 majori i parë i vitit 2014

10. Referuar konstatimit se në urdhër shpenzimet për kalimin e pagesave të TVSH, si rimbursim për projektet e huaja, praktika e kalimit të shpenzimit nuk kishte të bashkëlidhur dokumentacionin e duhur dhe të domosdoshëm për argumentimin e këtyre pagesave dhe referuar faktit që pikën 152 të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 2 datë 06.02.2012 “Për përdorimin e Standardeve të Përdorimit të Buxhetit” në të cilën theksohet se : “N/Z..... kontrollon dokumentet origjinale të mjaftueshme që vërtetojnë kryerjen e shpenzimit dhe kontrollet e tjera të nevojshme dokumentare”, me synimin e shmangies së pagesave jo të drejta dhe ligjore të TVSH sa më sipër.
Për këtë është rekomanduar që:

- Nga MBZHRAU në bashkëpunim me MF të përcaktojë dokumentacionin e domosdoshëm (standard) që duhet të jetë bashkëlidhur urdhër shpenzimit për pagesat e TVSH si rimbursim për financimin e huaj, ku domosdoshmërisht duhet të jenë: Marrëveshja për projektin së bashku me komponentët, kontrata e punimeve apo e shërbimeve, Kërkesa e Zbatuesit të projektit për rimbursimin e TVSH përkatëse, Urdhër i titullarit të Ministrisë përfutuese, Kërkesën e operatorit zbatues së bashku me situacionin e punimeve të miratuara nga institucioni direkt përfutues ose aktin e marrjes në dorëzim të mallrave ose pajisjeve si dhe fletë hyrjen e tyre në institucion, si dhe dokumentacioni i marrë nga drejtoritë rajonale tatimore për deklarimin e TVSH respektive të këtyre projekteve etj.

Menjëherë

11. Auditimi mbi administrimin dhe harxhimin e karburantit si dhe vendosjeve të normativave përkatëse për automjetet e aparatit të ministrisë, konstatoi mangësi jo vetëm të rregulloreve por edhe formalitet të procesverbaleve të mbajtura nga komisionet e përcaktimit të normativave të konsumit të karburantit. Normativat e konsumit të karburantit nuk janë bërë për çdo tip automjeti, dhe në përshtatje me konsumin fizik të tyre. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Nga MBZHRAU të merren masa, të përgatitet dhe miratohet rregullore e brendshme për lëvizjet e automjeteve, vendosjet e normativave të karburanteve për çdo automjet të administratës së ministrisë si dhe mënyrën e plotësimit të fletë udhëtimeve.

Menjëherë

- Në çdo fillim dhe fund viti, me komision të rregullt, të evidentohen me dokumentet përkatës numri i km. të rezultuara në kroskotet e automjeteve. Nëpërmjet marrjes së kësaj mase, të bëhet e mundur, që në evidencat tremujore për raportimin e karburanteve të harxhuara për çdo automjet, të vendosen vetëm km. faktike të përshkruara, e jo ato të nxjerra nga raporti i sasive të karburanteve të furnizuar me normativën e miratuar të harxhimit të karburantit, siç është vepruar deri më sot.

- Të merren masa, që përcaktimi i normativave të harxhimit të karburanteve për çdo automjet, të bëhet me komision të rregullt (jo me komisione shoferësh), duke nxjerrë mesataren nëpërmjet përshkrimit të provave teknike nga konsumi urban, extra dhe të kombinuar, të automjeteve që nuk kanë tregues kompjuterik për të treguar konsumin e karburanteve, ndërsa për automjetet që kanë tregues kompjuterik për të treguar konsumin e karburanteve, vetëm nëpërmjet të dhënave të nxjerra nga kroskotet.

Vazhdimisht

12. Nga MBZHRAU të merren masa, që për automjetet me targë TR5512K dhe TR3568R, që nuk janë pajisur me certifikata të kontrollit teknik, të kryejnë kontrollin teknik të detyrueshëm, me

qëllim, që të kontrollohen, nëse ato garantojnë sigurinë dhe qetësinë në qarkullim dhe, që ndotja e tyre nuk i kalon kufijtë e përcaktuar sipas rregullave të kolaudit. Gjithashtu për automjetet me targa TR3260F, TR5512K dhe TR3568R të bëhet pajisja me certifikatën e pronësisë së mjetit rrugor. Këto në mbështetje të ligjit nr. 8378 datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

Brenda datës 31/01/2014

13. Auditimi lidhur me procesin e formimit profesional, përditësimin e njohurive dhe edukimin e përditësuar të punonjësve të sektorit të auditit të brendshëm konstatoi se gjatë vitit 2012 dhe vitit 2013 (6 muaj) nuk janë kryer trajnime të detyrueshme, që sipas normave të Manualit të Auditimit janë 50 orë në vit. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Të bashkërendohen veprimet midis Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm dhe Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm për programimin e trajnimeve të detyruara për audituesit. Gjithashtu kjo drejtori duhet të organizojë trajnime të brendshme për te përgjithësuar gjetjet, fenomenet por edhe eksperiencën personale të audituesve.

Menjëherë

14. Në funksion të efikasitetit të sistemit të kontrollit të cilësisë nga DAB **është rekomanduar që:**

- Të rritet sistemi i kontrollit të cilësisë, rishikimin dhe vlerësimin e dosjeve të auditimit nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm, me qëllim që procedurat e rishikimit të cilësisë të mos mbeten thjeshtë një proces formal, por të shërbejë si një filtër dhe si vlerë e shtuar organizative për përmirësimin e cilësisë së auditimit. Gjurmët e auditimit për këtë proces të jenë pjesë e dosjes së auditimit për çdo proces auditimi.
- Të ndiqet me rigozitet kontabilizimi dhe realizimi i rekomandimeve të lëna gjatë misionëve të auditimit, sidomos për rastet e rekomandimeve për shpërbimin e demit si dhe të jepet referenca e pasqyrit të hollësishëm të këtyre çështjeve në raportin final
- Të kryhet arkivimi i dosjeve të auditit të brendshëm në arshivën e institucionit, pasi të jetë inventarizuar çdo informacion përbërës dhe sipas të gjithë kërkesave të ligjit Nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”, Manualit të Auditimit të Brendshëm dhe Normave tekniko-profesionale e metodologjike të shërbimit arkivor.

Menjëherë

15. Referuar faktit se nga DAB në ministri të Bujqësisë, Manuali i auditimit për MBUMK i hartuar, mbështetur në kërkesën e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Financave “Për hartimin e metodikave të Veçanta në zbatim të manualit të AB” nuk ka të pasqyruara këto metodika po përgjithësisht është një shkurtim i Manualit të miratuar nga Ministri i Financave, **është rekomanduar që:**

- Nga DAB të përmirësohet MAB i ministrisë me metodikat specifike të auditimit për subjektet ku kjo drejtori auditon, duke mbuluar të gjithë spektrin e specifikimeve që paraqesin institucionet e vartësisë, subjekt auditimi i kësaj drejtorie.

Menjëherë

16. Nga auditimi u konstatua se rregullorja ekzistuese është e miratuar nga ministri me datë 26.02.2010, me nr. protokolli të Miratimit 473/1 dhe nuk i përshtatet korrektësisht strukturës organike të miratuar në gusht të vitit 2013 si dhe asaj aktuale. **Për këtë është rekomanduar që:**

- Të bëhen përmirësime për përshtatjen e rregullores së institucionit, në përputhje me organigramën e tij, ku të kihet parasysh saktësimi më i detajuar i çdo pozicioni pune sipas përgjegjësisë referuar ligjit për MFK si dhe akteve në funksion të tij, delegimin e detyrave dhe kompetencave, etj.

Menjëherë

17. Referuar konstatimit nga auditimi, se në Ministrinë e Bujqësisë Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit nuk kishte rregulla të brendshme të miratuara për gjurmët e auditimit, për procedurat standarde të përdorimit të fondeve buxhetore për shpenzimet operative sipas llojit, për paga, për administrimin e aseteve dhe materialeve të institucionit si dhe të rregullave të procedurave të prokurimit publik, me synimin që të sigurohet se të gjitha operacionet e njësisë publike, dokumentohen në atë formë që u mundëson audituesve të brendshëm e të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse, të kuptojnë mjedisin e kontrolli, **është rekomanduar që:**

- Nga N/A dhe Titullari i institucionit në zbatim të nenit 9, pika 2 dhe nenit 16, pika 2, të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, të hartohen dhe të miratohen rregullat për gjurmët e auditimit për procedurat standarde të shpenzimeve, sipas udhëzimeve të nxjerra në zbatim të Ligjit

Menjëherë

18. Referuar konstatimit se, për periudhën objekt auditimi, procedurat e rezervimit të biletave të fluturimit me avion për jashtë shtetit, nuk kanë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshime, **është rekomanduar që:**

- MBZHRAU në bashkëpunim me Agjencinë e Prokurimit Publik, Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, të marrë masa për zgjidhjen e këtij problemi, nëpërmjet përcaktimit të procedurave të shërbimit të blerjes së biletave të fluturimit me avion.

Menjëherë

19. Referuar konstatimit nga auditimi se, në kryerjen e pagesave të vendimeve gjyqësore në të gjitha rastet e shlyerjes së detyrimeve nga vendimet gjyqësore, nuk janë nxjerrë përgjegjësitë administrative për personat përgjegjës, përpara kryerjes së likuidimeve të vendimeve gjyqësore, nuk ka asnjë gjurmë të përpjekjeve për të planifikuar grafikun e shlyerjes së detyrimeve për asnjë nga rastet e pagesave të kryera në mënyrë të plotë apo të pjesshme si dhe referuar konstatimit të auditimit që në 6 vendime gjyqësore, për ish punonjës të ministrisë, përcaktohet kthimi i tyre në vendin e mëparshëm të punës (vende që aktualisht janë të zëna nga punonjës me kontratë ose vakant) dhe detyrimi për pagimin e pagës përkatëse të tyre deri në momentin e kthimit në punë, **është rekomanduar që:**

a. Në çdo vit buxhetor nga secili institucion i vartësisë dhe aparati i ministrisë, të parashikohen fondet e nevojshme për likuidim, bazuar në vendimet për ekzekutim.

b. Nëpunësi autorizues dhe ai zbatues duhet të planifikojë grafikun e shlyerjes së detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore dhe të mos lejojnë kalimin për pagesë, të vendimeve gjyqësore, mbi bazën e dokumentacionit fotokopje.

d. Analizimin dhe nxjerrjen e përgjegjësive për dëmin ekonomik të krijuar si rezultat i pagesave të kryera nga zbatimi i vendimeve gjyqësore në shumën 2,125,584 lekë, ku vetëm për 6 punonjësit të cilët duhet të ktheheshin në punë është likuiduar vlera prej 440,000 lekë (pjesore dhe jo për të gjithë) dhe kur kjo shumë vjen e rritet deri në kthimin në punë të tyre.

Menjëherë

20. Nga auditimi, mbështetur dhe në informacionin e dhënë nga Drejtoria e Shërbimeve Tregtare, Sektori i Administrimit të Pronës, ka rezultuar mos arkëtim i detyrimeve kontraktuale si më poshtë:

a. Nga dhënia e tokave me qira, deri në fund të vitit 2012, në vlerën 74,247,165 lekë.

b. Nga mos arkëtimi i detyrimeve si rezultat i dhënies me qira të ambienteve pronë shtetërore për vitin 2012 dhe 6 mujorin e vitit 2013 rezulton një detyrim 597,060 lekë.

Për rrjedhojë shuma sa më sipër dhe në total **74,844,225 lekë** është e ardhur e munguar për buxhetin e shtetit. (Kjo shumë me detyrimet e sakta për gjithë vitin 2013 do të plotësohet me informacionin e marrë me mbylljen e vitit 2013). Me synim ndjekjen ligjore të këtij procesi, **është rekomanduar që:**

- Nga DAB në bashkëpunim me sektorin e administrimit të pronës, të verifikojnë nëse këto detyrime janë regjistruar në kontabilitet, dhe nëse kanë filluar procedurat ligjore dhe ndjekja e tyre deri në arkëtimin e shumave përkatëse detyrim i konstatuar.

- Nga titullari i ministrisë të udhëzohen institucionet e vartësisë, që për të gjithë subjektet të cilët përfitojnë nga veprimtaria e Ministrisë së Bujqësisë (financime, prokurime, leje apo licenca) tu vihet kusht, shlyerja e të gjitha detyrimeve ndaj institucionit.

Menjëherë

21. Nga MBZHRAU të merren masa, për të nxjerrë rregulla të brendshme, për organizimin e punës në sigurimin e hoteleve me koston më të ulët, konformë VKM nr. 870, datë 14.12.2011, pika 9.

Menjëherë

22. Nga Nëpunësit Autorizues dhe Zbatues i MBZHRAU të merren masa, që të mos kryhen likuidime të shpenzimeve për shërbimet jashtë vendit, pa u kompletuar me praktikat dokumentare, duke filluar nga e drejta për të përcaktuar nivelin e përfaqësimit të institucionit; miratimin e programit paraprak vjetor; ftesat e institucioneve të huaja, të përkthyer në gjuhën shqipe; autorizimet e titullarit; faturat e shpenzimeve për hotele dhe transportet, natyrisht për secilin punonjës (jo dokumente të agjencive); urdhër shërbimet me të gjitha nënshkrimet përkatëse, etj. të kësaj natyre, konformë Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 22, datë 10/07/2013 “Mbi zbatimin e VKM nr. 870, datë 14/12/2011”.

Vazhdimisht

23. Nga MBZHRAU të merren masa, që për çdo këmbim të monedhave të vendeve të huaja në euro ose dollar amerikan, detyrimisht të shoqërohen me dokumentet përkatëse bankare apo institucioneve të specializuara, duke ju bashkëlidhur urdhër shërbimeve për shërbimet e kryera jashtë vendit.

24. Referuar faktit të shlyerjes së faturave Ndërmarrjes së UK për konsumin e ujit të Aparatit të Ministrisë Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit me faturim aforfe, me synim shmangien e veprimeve abuzive në këtë drejtim, **është rekomanduar që:**

- Nga Drejtoritë e Shërbimeve në gjithë sistemin e ministrisë të verifikohen faturimet për energjinë elektrike dhe të ujit dhe të mos lejohet faturimi aforfe i këtij konsumi. Për rastet e avarive të pajisjeve matëse, të merren masat e menjëhershme sipas parashikimeve në kontratat me operatorët përkatës (CEZ dhe Ndërmarrje UK).

Menjëherë

25. Referuar fakteve të konstatuara në likuidimin e kontratave të shërbimeve nga aparati i ministrisë (kontrata e shërbimit të rojeve, kontrata e mirëmbajtjes dhe shërbimit të ashensorit, etj) ku likuidimi ishte bërë vetëm mbi bazën e faturës tatimore të operatorit dhe kontratën dhe jo mbi bazën e monitorimit të shërbimit (ku kjo duhej të vërtetohej nga raportet periodike të sektorit të shërbimeve të brendshme në funksion të detyrave funksionale) si dhe për faktin që detyrimi i monitorimit para kryerjes së pagesës nuk ishte i parashikuar në nenet e kontratës, **është rekomanduar që:**

a. Nga MBZHRAU në të gjitha rastet e lidhjes së kontratave të shërbimit, duhet të parashikojë mbikëqyrjen për kryerjen e shërbimit.

b. Për kontratat e lidhura dhe në vazhdim, pagesat periodike për kryerjen e shërbimit të realizohen duke pasur parasysh edhe raportet që vërtetojnë kryerjen e tij periodike, sipas parashikimeve në kontratë.

Menjëherë

26. Referuar faktit se në Kontratat e Qirasë “Për dhënien me qira të Ambienteve të shërbimit për Bar-Restorant në godinën e Ministrisë Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes Konsumatorit, në përcaktimet e saj mungojnë penalitetet që rrjedhin nga mos pagesa e qirasë, sipas afateve të përcaktuara në kontratë, si dhe referuar faktit që pagesat për qiranë e objektit Bar në godinën e MBUMK nuk ishte paguar sipas afateve të përcaktuara në kontratë, **është rekomanduar që:**

a. Nga MBZHRAU në kontratat të këtij lloji dhe të tjera, të vendosë rubrikat e penaliteteve sipas kërkesave të KPC, për mos zbatim të kushteve të kontratave të lidhura.

b. Për kontratën ekzistuese të bëhet monitorim periodik për zbatimin e nenit 4 të kontratës, që përcakton derdhjen e detyrimit deri me datën 5 të çdo fillim muaji.

Menjëherë

27. Referuar faktit se në MBUMK nuk është kryer inventarizimi i pronës së paluajtshme në zbatim të VKM nr. 820, date 13.10.2010 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat kalojnë në përgjegjësi administrimi MBUMK-së”, ku numri i tyre për inventarizim është 11.957 pasuri dhe referuar dhe faktit që ky proces është nisur, por nuk është realizuar sepse kërkohet:

a. Hartimi i dokumentacionit teknik të dosjes për çdo pasuri, si dhe angazhimin e strukturave përkatëse në administrimin e të cilave ndodhet pasuria;

b. Fonde të konsiderueshme për hartimin e dokumentacionit dhe të hipotekimit në ZRPV, **është rekomanduar që:**

- Nga institucionet e vartësisë në administrimin e të cilit ndodhet pasuria, të përcaktohet grafiku i inventarizimit të pronësisë në administrim, duke parashikuar për çdo vit kohën e hartimit dhe plotësimit me dokumentet e domosdoshme për hipotekim për çdo pasuri, si dhe fondet e nevojshme buxhetore që i korrespondojnë pronave të planifikuara për hipotekim në atë vit.

Menjëherë

28. Referuar faktit se në MBUMK vazhdon të gjente zbatim vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 439, datë 19.06.1995 “Për përballimin e limitit të shpenzimeve të telefonisë fikse të përballuara nga buxheti i shtetit”, ku në bazë të pikës 1 të vendimit, ministrit i janë rimbursuar deri në 700 impulse, gjithashtu nisur nga fakti se ky vendim ka dale jashtë funksionit dhe qëllimit për të cilën është miratuar, pasi janë në fuqi vendimet e Këshillit të Ministrave për përballimin e shpenzimeve të telefonisë celulare, të cilat paraqesin kategoritë që ju rimbursohen telefonat celularë, ku në këto kategori përfshihet dhe ministri, **është rekomanduar që:**

- Nga MBZHRAU të ndërpritet kryerja e pagesave në zbatim të vendimit të mësipërm.

Menjëherë

29. Referuar faktit se mallrat e prokuruar (pajisje zyrash) dhe të furnizuara nga Firma [REDAKTUAR] në zbatim të Kontratës se lidhur me nr. 2898/1 date 28.06.2013, nuk janë marrë në dorëzim sipas përcaktimeve në nenin 5 të kontratës për shkaqet e përcaktuara (nuk kanë përfunduar se ndërtuari zyrat e AKU në rrethe) dhe referuar kushteve të ruajtjes së mallit të përcaktuar në Aktmarrëveshjen e datës 19.08.2013 me nr. Protokolli 2898/4, ku këto pajisje do të çohen dhe montohen në destinacionin përfundimtar me përfundimin e objekteve ndërtimore, me qëllim marrjen në dorëzim përfundimtar të mallit sipas kushteve dhe cilësisë së parashikuar me specifikimet konkrete të përcaktuara kontratë dhe dokumentet standarde, **është rekomanduar që:**

- Nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave në bashkëpunim me AKU në rrethe, të cilat janë përfutuese të mallrave të kontraktuara të mbahen aktet pjesore të dorëzimit të mallrave, sipas cilësisë dhe specifikimeve të kontraktuara. Nga MBZHRAU në përfundim të këtij procesi, të hartohet dokumenti i marrjes në dorëzim përfundimtar i mallrave të kontraktuara me firmën [REDAKTUAR] Procesi i garancisë së mallrave të fillojë me marrjen dhe montimin e tyre në AKU përkatëse.

Menjëherë

B. MASA SHPËRBLIM DËMI.

1. Të ndiqen të gjitha rrugët ligjore (nxirret urdhri përkatës) për shpërblimin të efektit negativ financiar, të kryhen kontabilizimet dhe të bëhen ndalesat sa më poshtë vijon:

a. Për dëmin ekonomik në vlerën prej **85 \$** për sa përfshirë shërbimi i kryer nga Kompania për prenotimin e hotelit në Amerikë (Service Fees) të dy punonjësve në dy faturat e plotësuara po nga

kjo kompania si dhe **613 euro** për 10 raste, për kryerje të pagesave në kundërshtim me legjislacionin përkatës, si për pagesa hoteli pa dokumente të rregullta, ditë diete tepër, paguar bileta transporti për udhëtime brenda përbrenda qytetit, me metro, tramvaj, autobus, etj., të cilësuar hollësisht në aneksin nr. 1/2, bashkëlidhur. *(Trajtuar hollësisht në kapitullin 4, “Mbi auditimin e shpenzimeve të arkës në valutë” të Raportit Përfundimtar të Auditimit si dhe mbajtur procesverbali nr. 7, datë 18.10.2013).*

Menjëherë

b. Arkëtimi i dëmit ekonomik për 3 raste në vlerën prej 12,945,014 lekë, nga:

b.i) Firma fituese [REDAKTUAR] për tenderin me objekt “Konstruksion Stende dhe Porta Hyrëse për Panairin Kombëtar “Agrobiznesi–Turizëm 2012”, në vlerën prej **290,910 lekë**, për sa paguar më tepër nga MBUMK nëpërmjet likuidimit me urdhër shpenzimi nr. 383, datë 15/11/2012, të shoqëruar me faturën tatimore me tvsh nr. serie 84609571, nr. 21, datë 12/10/2012, duke përfshirë si në preventivin si fitues ashtu edhe në situacionin përfundimtar përkatës vlerën edhe të zërit të veçantë “Agency Fee” mbas llogaritjes së tvsh-së (10% e shumës totale të gjithë projektit), i cili nuk është zë pune.

b.ii) Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga [REDAKTUAR] Kryetar, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] Anëtar, në vlerën prej **4,858,097 lekë**, në tenderin e zhvilluar në platformën elektronike, me objekt: “Mbrotjtje nga Përmbytjet nga Lumi Osum në Velabisht, Berat”, për sa kanë shpallur fituesin e tenderit “[REDAKTUAR]” pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese, në një kohë që ka s’ kualifikuar edhe operator ekonomik të tjerë me oferta ekonomike me vlera më të vogla, ku në këtë rast duhej të ishte zbatuar neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 4 e LPP, që cilëson: *“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk devijojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”*.

Menjëherë

b.iii) Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga [REDAKTUAR] Kryetar, [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] Anëtar, në vlerën prej **7,796,007 lekë**, në tenderin në platformën elektronike të zhvilluar me objekt: “Mbrotjtje nga Gërryerjet e Lumit Buna, Fshati Oblik, Shkodër”, për sa kanë shpallur fituesin e tenderit [REDAKTUAR] pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese, në një kohë që kanë s’ kualifikuar edhe operator ekonomik të tjerë me oferta ekonomike me vlerë më të vogla, ku duhej të ishte zbatuar neni 53 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 4 e LPP, sa trajtuar në faqet 82-123 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Mbajtur procesverbali nr.7 datë 18.10.2013)

c. Për shpërblimin e shumës prej 263,240 lekë të harxhuar për pritje të të huajve në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 243 date 15.05.1995, të merret në analizë nga ministria dhe të përcaktohen punonjësit përgjegjës, sa trajtuar në faqet 44-52 të Raportit Përfundimtar të auditimit. (Mbajtur procesverbali nr.1 datë 29.10.2013)

Menjëherë

ç. Për shpërblimin e shumës prej 50.000 lekë të financuar për Institutin Bujqësor Kamëz në kundërshtim me nenin 51 të ligjit nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të merret në analizë nga ministria dhe të përcaktohen punonjësit

përgjegjës, sa trajtuar në faqet 44-52 të Raportit Përfundimtar të auditimit. (Mbajtur procesverbali nr.1 datë 29.10.2013)

Menjëherë

d. Shpërblimin për shumën 280,858 leke (pagesa për panaiet) nga [REDAKTUAR] në cilësinë e blerësit, pagesa pa dokumentacionin e nevojshëm dhe të domosdoshëm që vërteton kryerjen e shpenzimit. Këto shuma përfaqësojnë 12,858 lekë “ Elementë të tjerë” pjesë e urdhër shpenzimit Nr. 422, datë 7.12.2012; shuma 18,000 lekë “ dreke ekspertësh” pa kryer procedurën e parashikuar sipas vkm 243, datë 15.05.1995 të ndryshuar, paguar me urdhër shpenzimit nr. 424, datë 7.12.2012; shuma 100,000 lekë “ pagesë transporti me tepër nga përcaktimi i urdhrit të prokurimit, paguar me urdhër shpenzimit nr. 226 , datë 17.06.2013; shuma 150,000 lekë pagesë koktej për mungesë të dokumentacionit që vërteton kryerjen e shërbimit, sa trajtuar në faqen 44-52 të Raportit Përfundimtar të auditimit. (Mbajtur procesverbali nr.3, datë 29.10.2013)

Menjëherë

e. Shpërblimin për pagesat për biletë + hotel + dietë për udhëtimet jashtë shtetit. Kjo shumë përfaqëson shpërblimin nga punonjësit:

[REDAKTUAR] në shumën 100,956 lekë (hotel dhe biletë udhëtimi) në mungesë të dokumentacionit justifikues bashkëlidhur praktikës) paguar me urdhër shpenzimit nr. 32, datë 05.02.2013.

- [REDAKTUAR] në shumën 120 Euro (dietë e përfituar padrejtësisht) si rezultat i mungesës të dokumentacionit justifikues të udhëtimit, paguar me mandat pagesën nr. 32, datë 30.01.2013.

- [REDAKTUAR] në shumën 50 Euro dietë e përfituar padrejtësisht, paguar me mandat pagesën 23, datë 1.11.2012.

Menjëherë

f. Shpërblimin në shumën prej 26,986 leke detyrim për kthim nga 3 punonjës si rezultat i vendosjes se dokumentit jo ligjor te miratuar për dietat brenda vendit, bashkëlidhur urdhër shpenzimit ([REDAKTUAR] në shumën 16,162 lekë, [REDAKTUAR] 724 lekë, [REDAKTUAR] 7100 lekë, [REDAKTUAR] 3,000 lekë). (Mbajtur procesverbali nr.1, datë 29.10.2013).

Menjëherë

g. Kryerjen e pagesës së gjobës për Bashkinë Tiranë në shumën 24,360 lekë, si rezultat i pagesave me vonesë të taksave të Bashkisë, detyrim i ministrisë, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe arkëtimin e shumës së mësipërme nga punonjësit përgjegjës, sa trajtuar në faqen. 44 të Raportit Përfundimtar të Auditimit. (Mbajtur procesverbali nr.1, datë 29.10.2013)

Menjëherë

C. MASA DISIPLINORE

Cl.Mbështetur në nenin 25 “Masat disiplinore”, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa “b” për [REDAKTUAR]

Për kalim të shpenzimeve për pritje jo në zbatim të vendimin e KM nr. 243 date 15.5.1995” Për shpenzimet për pritje përcjellje dhe trajtimin që u behet delegacioneve të huaja”, të ndryshuar, pika 12 dhe pika 2, për shpenzimet e rezultuara nga blerja me vlerë të vogël për produktet ujë, kafe, çaj, pije, si dhe pritje drekte për të huajt. (Mbajtur procesverbali nr.1, datë 29.10.2013).

Për kalim të shpenzimeve (pagesa të TVSH + panaireset) në kundërshtim me udhëzimin nr.2 date 06.02.2012” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, ku theksohet se strukturat që përgatisin dokumentacionin për kalimin e shpenzimit (specialisti përkatës dhe N/Z), duhet që të sigurohen, që bashkëlidhur praktikës së shpenzimit të jetë i gjithë dokumentacioni që vërteton kryerjen e shpenzimit. (Mbajtur procesverbali nr.1, dhe nr. 3, datë 29.10.2013).

Për kalim të shpenzimeve me dokumente jo të miratuar nga MF (bileta dhe hotel për shërbime brenda vendit) si dhe jo në përputhje me urdhrin e Titullarit për udhëtimet jashtë shtetit (bordin pass datat e udhëtimit). (Mbajtur procesverbali nr.1, dhe nr. 2 datë 29.10.2013).

Për kryerjen e pagesave paradhënie për kontrata të lidhura në kundërshtim me ligjin nr. 9936, date 26.06.2008 “Për menaxhimin në sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 52, bie në kundërshtim me piken 152, 156, të udhëzimit nr.2 datë 06.02.2012” Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit.”, nenit 9,12,13 të ligjit nr. 10296, date 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”. (Mbajtur procesverbali me nr.4, datë 30.10.2013).

C2 Mbështetur në nenin 25 “Masat disiplinore”, të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil”, kërkojmë të fillojmë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa “b” për [REDAKTUAR]

Për përdorimin pa efektivitet të fondeve për panairin e verës në shumën 470.000 lekë “darkë festive”, pasi në kushtet e një shtrëngese buxhetore gjatë vitit 2012, jashtë qëllimit të realizimit të aktivitetit, ku sipas urdhrin të miratuar nga Ministri nr. 76, datë 16.03.2012 është përcaktuar vetëm ekspozim dhe konkurrim, dhe jo darka festive, dhe gjithashtu me propozimin e kësaj Drejtorie, titullarit të institucionit, është bërë realizimi i darkës festive me 100 të ftuar, në një kohë kur, referuar shpenzimeve dhe aktiviteteve të kryera në ditët e zhvillimit të këtij eventit ishte arritur qëllimi i organizimit. (Mbajtur procesverbali nr.3, datë 29.10.2013).

Për marrje të kompetencave dhe funksioneve të cilat i përkasin drejtorive të tjera, pa delegime të miratuara të këtyre funksioneve (blerje biletash për jashtë shtetit, si dhe blerje dhe firmosje faturash në cilësinë e blerësit në kushtet kur nuk është anëtare e komisionit të blerjes me vlera të vogla). (Mbajtur procesverbali nr.2 dhe nr.3, datë 29.10.2013).

Në funksion të detyrave funksionale të drejtorisë (Drejtorë e Shërbimeve Tregtare) për mos monitorim të kontratës [REDAKTUAR], të cilën dhe e ka firmosur në mbështetje të autorizimit të lëshuar nga Titullari i institucionit. Referuar kërkesës së grupit të auditimit nuk u vunë në dispozicion CD e emisioneve si dhe përmbajtja e të gjitha emisioneve, në funksion të faktit të realizimit të monitorimit si funksione të drejtorisë, ku dhe inicioni i këtij publiciteti ka qenë pikërisht nga Drejtorja e Shërbimeve tregtare).

Për mos zbatim të urdhrit të titullarit për dy rastet e konstatuara nga grupi i auditimit për udhëtimet jashtë shtetit, duke u kthyer në kundërshtim me këto urdhra, jashtë datave të caktuara nga titullari i institucionit.

C3. Mbështetur në nenin 25 "Masat disiplinore", të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe pikën 1 e 2 të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 "Për disiplinën në shërbimin civil", kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Vërejtje me paralajmërim", neni 25, pika 3, germa "b" [REDAKTUAR] me detyrë anëtare e komisionit (juriste) për zgjedhjen e medias për promovimin e industrisë Agroushqimore:

Për mos vendosje në dispozicion të dokumentacionit për përzgjedhjen e medias për promovimin e industrisë Agro-ushqimore me argumentin se ky dokumentacion nuk ishte arkivuar dhe nuk dispononte kopje të dokumentacionit që ajo kishte shqyrtuar dhe miratuar, në kushtet kur i gjithë komisioni (3 nga 5 anëtarë) kanë bërë deklarime me shkrim se nuk kishin dijeni se ishin anëtarë të komisionit dhe një anëtarë ishte i larguar jashtë shtetit. ". (Mbajtur procesverbali me nr. 4, datë 30.10.2013).

Shënim:

Gjatë auditimit u konstatuan mangësi dhe parregullsi edhe në punën e disa punonjësve tjerë por meqenëse janë të larguar nga MBZHR&AU, nuk propozohen masa disiplinore.

PROPOZIME PER AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

A. MASA ADMINISTRATIVE DHE DISIPLINORE

1. Në bazë të neneve 13 dhe 72 të LPP të ndryshuar të merren në analizë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për anëtarët e Njesisë së Prokurimit Publik, [REDAKTUAR] juriste në 8 tendera, [REDAKTUAR] anëtare në 6 tendera, [REDAKTUAR] anëtare në 3 tendera, [REDAKTUAR] anëtar në 3 tendera dhe [REDAKTUAR] anëtare në 2 tendera, për shkeljet e konstatuara në lidhje me procedurat e Prokurimit Publik, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse për mangësitë dhe shkeljet, si më poshtë vijon:

Për mos respektim të rregullave të prokurimit, në përputhje me dispozitat e këtij ligji të cilat përbëjnë kundravajtje administrative, pasi nga 8 tender të audituar, janë konstatuar në 7 tendera me mangësi e shkelje të njëjta të rregullave të prokurimit publik, ku më kryesorët përmendim: janë përgatitur dokumentet e tenderëve pa u nxjerrë më parë shkresat zyrtare për caktimin e punonjësve të specializuar dhe grupet e punës, për të përcaktuar specifikimet teknike si dhe llogaritjet e vlerave të fondeve limite, konformë Urdhrit të Ministrisë së Financave Nr. 92, datë 29/12/2011 "Gjurmët Standarde të Auditit për Prokurimin me Vlera të Vogël dhe të Lartë", etj.; nuk janë marrë masat për të siguruar ndarjet e detyrave të zyrtarëve/ nëpunësve të përfshirë në hartimin e dokumenteve të tenderit (njësisë së prokurimit) dhe atyre të përfshirë në procesin e vlerësimit dhe të përzgjedhjes së fituesit (KVO-ve); nuk është bashkëpunuar në kuadrin e këshillimeve me Avokaturën e Shtetit para hartimit dhe nënshkrimit të kontratave administrative (të përcaktuar në nenin 151 të Kodit të Procedurës Administrative-ligji nr. 8485, datë 12.05.1999, me ndryshimet duke lidhur ndonjë marrëveshje sipas ligjit nr. 10018, datë 13/11/2008 "Për

Avokaturën e Shtetit”, neni 15, pika 3 dhe VKM nr. 392, datë 8/4/2009, Kreu VI, neni 26/1, neni 27/2; nuk janë cilësuar në urdhrat e prokurimeve arsyet e përdorimit të procedurave; kontratat e lidhura, në nenet përkatëse “Dëmet e likuidimeve për vonesën në mbarimin e punimeve, shërbimeve apo furnizimeve”, janë vendosur të tri klauzolat e penalteteve, në një kohë që duhej fiksuar vetëm penalteti i afatit kohorë të caktuar për dorëzimin e punimeve, shërbimeve apo furnizimeve në konkurrim; dosjet përkatëse të fituesve të tenderave, nuk janë plotësuar me shtojcën nr. 4 “Lista e informacionit konfidencial”, që plotësohet nga operatori ekonomik, ku duhet të shënojnë informacionin që dëshirojnë të mbahet konfidencial, kjo e domosdoshme për tu shmangur ndonjë konflikti gjyqësor për ruajtjen e llojit, natyrës e informacioneve që duhet të mbeten konfidencial për llogari të konkurrenteve; inventarët e dosjeve janë bërë, por nuk janë të plota, pasi për vitin 2012 kanë nënshkrimin e vetëm dorëzuesit (përgjegjësit të sektorit të prokurimit publik) dhe nuk kanë nënshkrimin e marrësit në dorëzim, pra nuk është bërë konformë ligjit mbi arkivat; aparati i ministrisë, ka përqendruar disa tender me urdhër të Ministrit, pa bërë më parë argumentimet përkatëse për arsyen e përqendrimit, siç përcakton ligji, nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, neni 11, pika 2 dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu I, pika 2, germa (a), (c); (ç) dhe (d); nuk u kanë kthyer përgjigje apo liruar sigurimet e ofertave operatorëve ekonomik pjesëmarrës në konkurrim, të cilët nuk janë shpallur fitues.

Disa nga kërkesat kualifikuese të veçanta, Njësia e Prokurimit nuk i ka vendosur dhe argumentuar me hollësi sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës së tenderit të prokuruar, sipas rregullave të prokurimit publik. Gjithashtu, mbështetur në nenin 1 të LPP, autoriteti kontraktor duhej të synonte nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomik në procedurën e prokurimit publik, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomik si dhe të bënte stimulimin e biznesit të vogël dhe të mesëm.

Rastet që u konstatuan janë si më poshtë:

- në tenderët e punëve (ndërtimit), janë kërkuar për t’u paraqitur “Licencat profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës” me kategoritë, por se mes të tjerave për disa kategori punimesh janë cilësuar gerrat përkatëse të nivelit të klasifikimit dhe për disa kategori të tjera nuk janë cilësuar gerrat përkatëse të nivelit të klasifikimit të shoqërisë (po në të njëjtin tender), që i korrespondojnë vlerave në lekë të punimeve të kryera për çdo kategori punimi, si dhe nuk është cilësuar institucioni përkatës që i lëshon këto licenca;
- në miratimin e kërkesave kualifikuese të veçanta për disponueshmërinë e aseteve dhe makinerive, Njësia e Prokurimit përveç shtojcës nr. 9 (të miratuar me DST), ka kërkuar njëkohësisht edhe dokumente shtesë deri në momentin e hapjes së procedurës së prokurimit, dokumente të cilat në shumë raste nuk kanë më fuqi vepruese mbas lidhjes së kontratave (u ka kaluar afati i përdorimit të dokumenteve). Pra, kjo kërkesë për kualifikim, nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm si dhe nuk është sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik;
- në të gjithë tenderët e audituar, janë kërkuar paraqitja e certifikatës origjinale të gjendjes financiare nga një ose me shumë banka;
- në numrin e punonjësve të punësuar, Njësia e Prokurimit ka kërkuar si dokument vërtetues prove, mes të tjerave, që operatorët konkurrues duhet të paraqesin formularin Esig-25a si dhe listë pagesat e konfirmuara nga sigurimet shoqërore. Në fakt, nuk ka dokument të tillë më vete tip formulari “Esig-25a”, pasi janë vetë listë pagesat që kanë siglën “Esig-25”. Gjithashtu ka kërkuar numrin e të punësuarave me interpretime, pasi nuk del e qartë nëse ky numër është në total për tre vitet e fundit, nëse është mesatar për tre vitet e fundit apo është kërkuar për një periudhë të caktuar, madje nuk është kërkuar e përcaktuar as periudha më e afërt me datën e zhvillimit të tenderit;

- për tenderët e punimeve (ndërtimit) është kërkuar kërkesë kualifikuese, që Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike. Kjo nuk është kërkesë kualifikuese dhe nuk ka asnjë dokument për ta vërtetuar kryerjen e një veprimi të tillë, pasi sipas DST është vetë shtojca nr. 9 “Deklarata e disponueshmerise së makinerive dhe aseteve”, ku në fund të kësaj shtojce është cilësuar autorizimi nga operatori ekonomik për autoritetin kontraktor për të kryer verifikimet e informacionit përkatës të dhënë në këtë shtojcë;

- në tenderët e ndërtimit (punimeve) janë kërkuar kërkesë kualifikuese paraqitja e analizave të çmimeve për të gjitha zërat e punimeve të paraqitura në preventivin konkurrues, në momentin e hapjes së tenderëve, në një kohë, që këto analiza mund të kërkojnë në qoftëse konkurrentët do të paraqiten me vlera anomalish të ulët dhe sipas legjislacionit përkatës kërkojnë analiza të çmimeve të disa zërave të punës duke i argumentuar sipas nenit 56, pika 1 e LPP si dhe VKM nr. 1, datë 10/01/2007, me ndryshimet, Kreu III, pika 3, germa (a). Një veprim të tillë e argumentojnë edhe DST, procedura e hapur për punët, pika 3 “Vlerësimi i ofertave”, nënpika 3.4 “Ofertat anomalisht të ulëta”. KVO-të kanë bërë s’kualifikime të konkurrentëve që nuk kanë paraqitur qoftë edhe vetëm një zë pune të preventivit të konkurrimit, edhe pse me vlera më të vogla në ofertat ekonomike se fituesit e shpallur;

- në tenderët e punëve (ndërtimeve) është kërkuar si kërkesë kualifikuese pasja dhe paraqitja e certifikatave ISO, dokument i cili lëshohet nga organizmat e huaja. Kjo kërkesë nuk është e plotë pasi nuk është cilësuar se nga do të merret ky dokument. Gjithashtu, edhe cilësimet e bëra nga Njësia e Prokurimit të llojit të certifikatave nuk është e plotë, pasi për tenderët e audituar janë kërkuar me cilësime të ndryshme dhe tepër të hollësishme. Këto lloj cilësimesh kanë vënë në dilemë edhe KVO-të dhe si rezultat shumë konkurrues nuk janë paraqitur me të tilla cilësime të hollësishme dhe në këto kushte sipas legjislacionit të prokurimit publik duhet të ishin s’kualifikuar si p.sh. teksti i kërtimeve të autoritetit kontraktor: “Ofertuesi duhet të paraqes certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001:2008 në përputhje me natyrën e punimeve që do të kryhen në këtë objekt (punime bonifikimi). Ose kërkuar, që Ofertuesi duhet të paraqesë certifikatën e cilësisë së punimeve ISO 9001:2008 punime bonifikimi (Impiante Hidrike)”, etj. të kësaj natyre.

Pra, për të njëjtat natyrë kontratash objekt prokurimi, një herë është kërkuar punime bonifikimi dhe një herë tjetër punime bonifikimi-impiante hidrike. Në fakt nuk mund të sigurosh të tilla certifikata me cilësime kaq të hollësishme. Pra, ato duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mos diskriminimit.

Në zbatimin konkret të këtyre kërkesave, KVO-të kanë pasur vështirësi në shpalljen e fituesve, pasi në qarkullim janë lëshuar certifikata të tilla me përshtime nga më të ndryshme. (Trajtuar hollësisht në kapitullin 7 “Prokurimet publike” të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2. Në bazë të neneve 13 dhe 72 të LPP të ndryshuar, të merren në analizë shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për anëtarët e Komisioneve të Vlerësimit të Ofertave [redacted] kryetar në 5 tendera, [redacted] anëtar në 6 tendera dhe [redacted] anëtare në 6 tendera, për shkeljet e konstatuara në lidhje me Procedurat e Prokurimit Publik, duke nxjerrë dhe përgjegjësitë përkatëse për mangësitë dhe shkeljet, si më poshtë vijon:

Për shkelje të dispozitave të këtij ligji, pasi nga 8 tendera të audituara, janë konstatuar 7 tendera me mangësi e shkelje të procedurave të zhvillimit të tenderëve, ku më kryesorët përmendim:

- të gjithë anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave, për rastet e argumentimeve të s’kualifikimeve të operatorëve ekonomik konkurrues në platformën elektronike, kanë paraqitur të

njëjtat tekse, pa asnjë ndryshim nga njëri tjetri, madje edhe me të njëjta gabime ortografike. Anëtarët e komisioneve të vlerësimit të ofertave duhet të hyjnë individualisht në platformën elektronike, nëpërmjet llogarisë së tyre të përdoruesit dhe fjalëkalimeve personale dhe duhet të japin mendimet më secili më vete. Kjo në mbështetje të legjislacionit të prokurimit publik si dhe të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik “Për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave në prokurimin publik me mjete elektronike”, paragrafi i vlerësimit të ofertave bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit, që cilëson: *“Anëtarët e Komisionit dhe Vlerësimit të Ofertave, hyjnë individualisht në sistemin elektronik, duke shkruar llogarinë e tyre të përdoruesit dhe fjalëkalimin e vlefshëm. Kur të gjithë anëtarët e KVO-së kanë përfunduar procesin e vlerësimit të ofertave, atëherë sistemi është gati për të treguar renditjen përfundimtare”*;

- në asnjë tender të audituar nuk janë lënë gjurma për kryerjen e veprimeve aritmetikore nga KVO-të. Ky veprim duhej bërë konformë VKM nr. 1, datë 10/01/2007, i ndryshuar, Kreu V-Zhvillimi i procedurave, pika 4-Hapja dhe vlerësimi i ofertave, germa (ç). Gjatë auditmeve dhe veprimeve të kryera u konstatuan raste të paraqitjeve së konkurrentëve, madje edhe fituesve të tenderave, me gabime të kryerjeve të veprimeve aritmetikore në ofertat e tyre ekonomike, gabime në të cilat pati raste që vlerat e ofertave ekonomike rezultuan mbi vlerat e fondit limit të konkurrimit;

- në asnjë tender nuk janë lënë gjurmë për llogaritjet e vlerave anomalish të ulët. Llogaritjet e vlerave anomlisht të ulët duhet bërë konformë VKM nr. 1, datë 10/01/2007, i ndryshuar, Kreu V-Zhvillimi i procedurave, pika 4-Hapja dhe vlerësimi i ofertave, germa (ç), që cilëson: *“Pas mbylljes së seancës publike, komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, , që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik”*. Gjatë auditmeve dhe veprimeve të kryera u konstatuan raste të paraqitjeve së konkurrentëve, madje edhe fituesve të tenderave, me vlera anomalish të ulët;

- raportet përmbledhëse të vlerësimit të procedurave të prokurimeve për vitin 2013, që u janë dërguar për miratim titullarit të autoritetit kontraktor, janë nënshkruar vetëm nga Kryetari i KVO-ve, në një kohë, që duhej të ishin nënshkruar nga të gjithë anëtarët e KVO-ve. Një kërkesë e tillë është cilësuar në VKM nr. 1, datë 10/01/2007, i ndryshuar, Kreu V-Zhvillimi i procedurave, pika 4-Hapja dhe vlerësimi i ofertave, germa (gj).

- u konstatuan dëme ekonomike ekonomik për buxhetin e shtetit në 3 tendera, në vlerën totale prej **12,945,014 lekë**, për mos zbatim të procedurave në shpalljen e fituesve si dhe pa plotësuar kërkesat kualifikuese. Pra, KVO-të kanë shpallur fituesit pa plotësuar 100% kërkesat kualifikuese si dhe kanë s’kualifikuar operator ekonomik konkurrues, që janë paraqitur me vlerë më të vogël se fituesit.

Në këto kushte, sipas legjislacionit të prokurimeve publike në fuqi, fituesit duhej të ishin s’kualifikuar dhe tenderi duhej anuluar e përsëritur nga e para, pasi numri i konkurruesve për vitin 2012 mbetej vetëm me një konkurrent, ose për vitin 2013 tenderi mbetej pa asnjë konkurrent. Meqenëse KVO-të nuk kanë vepruar në këtë mënyrë, atëherë në mbështetje të kriterit të vlerësimit, që ka miratuar Njësia e Prokurimit Publik **“çmimi më i ulët si kriter vlerësimi”** si dhe në mbështetje të nenit nr. 53, pika 4 e LPP, që cilëson: *“Autoriteti kontraktor vlerëson një ofertë të vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë materialisht ose nuk deviojnë nga karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo gabime, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj”*, duhej të kishin shpallur fitues vetëm konkurrentët, që janë paraqitur me vlerë më të vogla, çka do ti kishin kursyer buxhetit të shtetit si dhe do të kishin mbështetje të legjislacionit të prokurimeve publike në fuqi. Autoriteti kontraktor këtë veprim nuk e ka kryer, pasi ka shpallur fituesit me vlerë më të larta, edhe pse nuk i kanë plotësuar 100% kërkesat kualifikuese.

Këto në mbështetje edhe të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V “zhvillimi i procedurave”, pika 2. *(Trajtuar hollësisht në kapitullin 7 “Prokurimet publike” të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

KONTROLI I LARTË I SHTETIT